



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL IX/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 9(nëntë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 27.09.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Znj.Saranda Bajraktari	Të pranishëm të tjerë
Z.Selman Kolgeci	Z. Driton Maliqaj	
Z. Flamur Bytyqi	Z. Xhevshet Gashi	Kryetari i Komunës
Z. Urim Suka	Z.Edon Sadikaj	Media dhe qytetarë
Z. Kushtrim Kuçi	Z.Dardan Berisha	OSCE, LMT, KDI
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Bajram Basha	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi	Znj.Mevlude Kabashi	Z.Xheladin Sadikaj
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z.Alban Berisha	Znj.Laureta Tafaj	
Z. Bexhet Kuçi	Z.Liridon Fandaj	
Z. Reshat Selimaj	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Lirim Qatani	Znj.Festë Kabashi	
Z. Aziz Bytyqi	Z.Herolind Limaj	
Znj.Sanie Kuçi	Znj. Jehona Rrafshi	
Rexhepaj		
Znj.Mimoza		
Bajrakatari		
Znj.Fidaije Kukaj		
Znj. Afërdita Morina		

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2023;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi” ;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës-2022-2030 (HZK);**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publikë ;**
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditorit të brendshëm për periudhën janar-dhjetor 2021 ;**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Festë Kabashi - përshëndet të pranishmit.Ju e dini që rezultati i zgjedhjeve të fundit përcaktoi që edhe Lista Guxo të fitojë një ulëse në këtë legjislaturë dhe unë të jem përfaqësuesja e vetme e saj në Kuvendin Komunal të Suharekës.Duke marrë parasysh këtë fakt unë isha plotësisht e bindur që bashkëpunimi mes meje dhe listës që përfaqësoj do të thellohej dhe pse jo të ishte dhe produktiv, mirëpo kjo gjë nuk ndodhi as edhe një herë.Andaj erdhi koha që unë të reflektoj.Të nderuar, që nga ky moment unë nuk jam më përfaqësuese e listës Guxo,edhe pse me raste të caktuara nuk jam pajtuar me politikat e qeverisë në nivel qëndror e në veqanti në fushën e arsimit.Pranoj haptas që kolegët asambleist nga Lëvizja Vetvendosje asnjëherë nuk më kanë bërë të ndihem e anashkaluar dhe çdo herë jam ndier e barabartë në mesin e tyre.Për hirë të korrektësisë ndaj grupit tim,unë vendos të tërhiqem nga i vetmi komision në të cilën jam anëtare. Nga sot rrugëtimin tim politikë do ta vazhdojë si këshilltare komunale e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit.I uroj Festës mirëseardhje,bashkëpunim të plotë dhe të sinqert,natyrisht në funksion të realizimit dhe interesave të qytetarëve.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit.Falemnderojmë Festën për bashkëpunimin që kishim mes vete,dhe i uroj më të mirat në gupin tjetër parlamentar.

Urim Suka - e drejta e secilit asambleist është me marrë drejtimin e tij. Uroj që ky drejtim që Festa ka marrë, mos të jetë shkak i ndonjë presioni të pushtetit për me i shtu radhët e tij, por të jetë vendim i saj. I uroj suksese.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Në emër të PDK-së i uroj Festës suksese në rrugëtimin e saj politikë duke iu bashkuar grupit të AAK-së.

Pika 1.

Kryesuesi - pasi nuk ka vërejtje, e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - jemi këtu në seancën e radhës së Komunës, e për fatin e keq edhe pse ka gati një vit që adresojmë çështje e dëshmojmë me fakte keq-qeverisjen tuaj. Ju vazhdoni formulën e njejtë duke treguar joserozitet në shumicën e vendimeve që ju sillni në këtë Kuvend. Në dhjetorin e vitit të kaluar ashtu sikur sot kemi trajtuar projekt-buxhetin i cili edhe pse ishte dokumenti më i rëndësishëm, ju e keni sjell krejtësisht të papërgaditur për të cilin ne dhamë kritika, por ju nuk dëgjuat duke e miratuar njëanshëm. E vërteta është se ai buxhet është kthyer dy here nga qeveria për shkak të keqplanifikimit të tij. Dhe për çudi ju sot sillni projekt-buxhetin e vitit 2023 në logjikën e njejtë me vitin e kaluar. I nderuar Kryetar, ju drejtorja Komunal, kolegë Kuvendarë, qytetarë të nderuar, projekt buxheti si një dokument kryesor që ky Kuvend merr, do të duhej të kishte vëmendjen maksimale tuajën me qëllim të një ofrimi të një buxheti zhvillimor për Komunën tonë. Lidhur me këtë ju keni organizuar disa dëgjime publike, por vërehet qartë se nuk i keni marrë shumë konsideratë shqetësimet qytetare në këto dëgjime publike. Këtë e bazoj në faktin që në listen e investimeve kapitale për vendbanimet veq e veq, pothuj në të gjitha keni planifikuar vetëm investime në ndërtimin e rrugëve lokale duke anashkaluar projekte tjera për të cilat kanë ngritur shqetësime qytetarët në këto dëgjime publike. Gjatë analizës që i kam bo këtij buxheti, më lejoni ti paraqes disa nga shqetësimet e mijë. Kërkoj të më shpjegoni si ka mundësi që nga 10 rrugë të planifikuara në fshatin Mushtisht për vitin 2023, 7 prej tyre figurojnë në kontratën që keni nënshkruar për vitin 2022? Dy rrugë në fshatin Javor për vitin 2023 i keni të planifikuara për ti realizuar në vitin 2022. Njejtë është situata me rrugën “Afrim Buqa” në Luzhnicë. Poashtu situatë e njejtë është në fshatin Tërrnje, me rrugën “25 Marsi”. Kryetar, në Gjinoc prej nga dhe vjen, ke planifikuar në buxhet ndërtimin e rrugës “Sherif Aga”, por ju këtë vit keni hartu një kontratë për ndërtimin e kësaj rruge. Më thuaj, a ke me rregullu këtë rrugë në vitin 2023 apo në vitin 2022, siq është në kontratë. A ka mundësi dikush nga ju të më tregoj, si po planifikoni me rregullu rrugë të vitit 2023 të cilat veq janë në kontratë në vitin 2022. Kur jemi te prioritetet se cilat rrugë duhet të shtrohen, fatkeqësia është që ju keni prioritet rrugët e oborreve, para rrugëve që lidhin disa shtëpi, më konkretisht rruga “Kastriotët” në Leshan është rrugë që frekuentojnë rreth 10 shtëpi dhe është e pashtruar, kurse ju po shtroni rrugë me nga dy e tri shtëpi. Si ka mundësi që për vitin 2023 keni planifiku ndërtimin e QKMF-së në Duhël, Studenqan e Gjinoc, ndërsa në vitin 2022 keni kontratë për rregullimin e oborreve në këto qendra. Si ka mundësi që për vitin 2023 keni planifiku 10 mijë euro për rregullimin e oborrit të Komunës dhe po për këtë vit keni planifiku 50 mijë euro për ndërtimin e objektit të ri të Komunës. Kryetar, një kohë të gjatë na ke fol për sistemin e Dragaqinës dhe deri tani vetëm fjalë ke pas, por e vërteta është se edhe tri vitet e mbetura s’ke planifiku fare buxhet. Në një strategji të zhvillimit ekonomik lokal, na ke fol për trajtimin e ujërave të zeza, për miniimpiante. Trego se ku është buxheti për këto miniimpiante? Poashtu në këtë buxhet keni nda 99 mijë euro për ndërtimin e urave në Semetisht dhe Mushtisht, por në Bllacë është harruar pasi që nuk është pastruar asnjëherë shtrati i lumit, gjithëashtu ura në hyrje të fshatit është pa rrethoja dhe paraqet rrezik për fëmijët. Lidhur me planifikimin e buxhetit në

arsim,në këtë buxhet keni nda mjete për ndërtimin e një aneksi në shkollën “Besim Ndreca” në Maqitevë e gjithëashtu keni nda mjete për ndërtimin e sallave të sportit në Muhlan,Sallagrazhdë e Sopijë,për të cilat ke mbështetjen tonë.Çka do të bëhet me shkollën 7 Marsi?Mendoj që ajo shkollë duhet ta ketë një objekt të ri.A do të kemi aneks-ndërtim edhe në shkollën “Ismet Jashari-Kumanova “ në Javor?A do të kemi investime në shkollën në Reqan?Gjithëashtu keni nda buxhet për renovimin e shkollave,ku keni përmend edhe shkollën në Reshtan,për çka edhe unë pajtohem,por në këtë planifikim keni përmend edhe gjimnazin “Jeta e Re”.Por ajo që unë di,është se ju sivjet keni investu në gjimnaz,madje punimet atje s’e di a kanë përfundu.Me që po investohet në gjimnaz,pse ka nevojë prap,apo është keqplanifikim.Lidhur me planifikimin e buxhetit Kulturë Rini dhe Sport, nga ju Kryetar kemi dëgju shumë premtime për shtëpinë e kultures,por në buxhet nuk figuron askund.Kur do të përmbyllet ky projekt sepse ke 5 vite në pushtet?E di që landa ka qenë në OSHP,por tani duhet të kemi një orientim se si do të përmbyllet ky projekt.Kohën e fundit kemi dëgjuar edhe premtime e zotime për ndërtimin e stadiumit të ri të futbollit,mirëpo në buxhetin që keni sjell nuk figuron asnjë euro për këtë projekt.Kjo tregon për mungesën e joseriozitetit tuaj kur i adresohesh opinionit publik dhe qasjen tuaj për përvetësimin e meritave e punëve që tjerët bëjnë,siq ishte edhe rasti i fundit i rrugës Mushtisht deri në Malësinë e Re.Kur jemi te kultura,më kujtohen disa zotime tuaja për investimet në kullën Ramë Bllaca.Tri here ke bo zotime atje dhe deri më tani nuk ke bo asgjë.Si është e vërteta për këtë dhe çka do të bëni në të ardhmen?Se ky buxhet nuk mbron interesat qytetare shihet edhe në faktin që ju keni nda 140 mijë euro për blerjen e veturave për vitin 2023.Ndoshta keni nevojë për vetura të reja,por mendoj që 140 mijë euro janë shumë .Ky buxhet është i keqplanifikuar dhe nuk mbron interesa qytetare dhe si i tillë nuk ofron zhvillim për Komunën tone dhe rrjedhimisht vota jonë është kundër këtij buxheti në formën siq e keni sjellë.Prandaj në emër të grupit të LDK-së kërkoj nga secili prej jush që këtë buxhet të mos e miratojmë në këtë formë,por të kthehet e të rishikohet e në një seancë tjetër të miratohet pas përmirësimeve të nevojshme.

Selman Kolgeci - ky projekt-vendim për vitin 2023 në krahasim me buxhetin e miratuar për vitin e kaluar,ka pësuar ndryshime edhe pse përsëri është larg nga një buxhet me prioritete.Janë evidentuar parregullsi siq i ceki edhe kolegu im parafolës.Unë konsideroj që buxheti duhet ti nënshtrohet disa ndryshimeve me qëllim që kjo qeverisje të jetë transparent para qytetarëve,para opozitës,institucioneve dhe para asambleistëve të vet.E kam përsëritur disa here që banorët në fshatin Vraniq e kanë prioritet furnizimin me ujë të pijes dhe funksionalizimin e varrezave të reja sipas vendimit të Asamblesë.Në anën tjetër përfundimi i rrugëve të fillume dhe përfundimi i rrugëve tjera janë shumë të rëndësishme për jetën e qytetarëve tanë sikur është e rëndësishme të dihet se çka ka ndodhë në kontratat tjera të lidhura për investime në Vraniq.Poashtu është shumë i rëndësishëm ndërtimi i infrastrukturës për turizëm në bjeshkën e Vraniqit.Ky i fundit ishte pjesë e programit të LDK-së në zgjedhjet lokale.Jam mirënjohës që keni përfshirë ndërtimin e disa rrugëve dhe ndërtimin e infrastrukturës për turizëm,por kërkoj që të planifikohet buxhet edhe për dy prioritetet e para.Temë tjetër,mosplanifikimi buxhetor për hartimin e projekteve.Kjo po ndikon që projektet të realizohen duke mos respektuar asnjë standart apo normë teknike ndërtimore.E kam ngrit si çështje edhe më praë,por nuk e di pse po vazhdohet në këtë formë kur e dini mjaft mire që jeni duke e dëmtuar secin projekt në cilësi,n’fukson dhe n’sasi.Për të njejtën gjë ju i jeni përgjigjur auditorit të përgjithshëm në strategjinë e hartuar për evitimin e përsëritjes së shkeljeve në raportin e auditorit se do të hartoni projekte për secilin investim,pra nisjes së procedurave të prokurimit.Ku e keni buxhetin për këtë zotim e obligim tuajin?Si do të hartoni projekte pa buxhet?Pyetje Drejtorit të Urbanizmit në lidhje me buxhetin e planifikuar për ndërtimin e rrethojave urbane.Keni planifikuar 150 mijë euro për këtë project,kërkoj sqarim se për çfarë saktësisht po bëhet fjalë dhe ku do të vendosen ato rrethoja?Në Drejtorinë për Kulturë Rini Sport,për vitin 2023 i keni planifikuar 400 mijë euro,ndërsa në KAB 2023-2025 i keni planifikuar ti ndani 1.650629 euro,dhe nga kjo shumë nuk e keni ndarë as edhe një euro për finalizimin e shtëpisë së kulturës “Ukë Bytyqi” në Suharekë.Këtë projekt e keni të trashëguar nga qeverisja e LDK-së, me ndarje buxhetore e me projekt detal. 5 vite nga atëherë,ju nuk po jepni vëmendjen që meriton ky projekt,i cili si për nga funksioni që do të ketë dhe si për nga emri që mban meriton ti kushtohet vëmendje e të investohet seriozisht në të.Prej një projekti me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e aktiviteteve kulturore ,ju me mos investime serioze n’këtë projekt,po e shëndrroni nga një vend të kultures në një vend të shfrytëzimit të dukurive negative.Për këtë kemi edhe

rastin e shtëpizave tek shtigjet e ecjes që ka qenë një rast i ngjashëm. Po e shoh që listen e investimeve kapitale të miratime nga Asambleja po e devijoni e po ndërroni projekte sipas tekeve tuaja personale. Kjo më jep të kuptoj që buxhetin po e kaloni si formalitet ndërsa punët në teren po i bën sipas dëshirës. Ju e dini se kjo është shkelje e ligjit dhe devijim i vullnetit të asambleistëve.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit. Planifikimi i buxhetit është ndoshta njëri prej vendimeve ma të rëndësishme që çdo vit Asambleja Komunale shqyrton dhe miraton për vitin që vjen. Unë po e marrë fjalën jo vetëm si asambleiste por edhe si Kryetare e grupit të Grave, asambleisteve të Komunës tone. Ne si grup i grave jemi të përkushtuara që përmes mekanizmave të ndryshëm të mbështesim e të fuqizojmë grata në Komunën tonë, e normalisht planifikimi i buxhetit është një mekanizëm të cilën ne e kemi shfrytëzuar para kësaj seance me takime të shumta që i kemi mbajtur, në mënyrë që të adresojmë disa rekomandime dhe kërkesa tona, në mënyrë që ekzekutivi të gjejë forma ligjore për realizim të këtyre rekomandimeve. Me që jam pjesë e KPF-së, unë edhe në KPF mora fjalën për me i listu të gjitha rekomandimet, që ne si grup i grave i kemi adresu te zyra e Kryetarit dhe e Kuvendit, dhe të kërkoj gjithëashtu sqarim qoftë nga Drejtori i Financave apo ZKF, dhe të na njoftojë se këto kërkesa a kanë gjetë zbatim në planifikim të buxhetit për vitin e ardhshëm. Kërkesa 1. Biznes startapet për grata në vlerë rreth 50 mijë euro. Qëllimi jonë është që përmes këtij fondi të jenë përfitues rreth 5-7 gra me projekte konkrete. Kërkesa 2. Përkrahja me paisje elektronike apo lloptop për fëmijë me sëmundje të veqantë që iu pamundësohet shkollimi. Qëllimi jonë është që këta fëmijë të kenë mbështetje sado të vogël institucionale. Kërkesa 3. Përkrahja e grave fermere ose që synojnë të fillojnë në bujqësi në raport me fermerët. Qëllimi jonë është që gjatë ndarjes së fondeve për sera, fidane apo qfarë do subvencioni tjetër, të gjenden forma ligjore që stimulojnë aplikimin e sa më shumë grave fermere dhe që lista e përfituesve të jetë 50% /50% fermer-fermere. Kërkesa 4. Të rritet përkrahja për Qendrën e strehimit të grave dhe fëmijëve në Prizren. Qëllimi jonë është që të ketë sa më pak raste nga dhuna familjare, e me ç'rast të ulet edhe numri i kërkesave për strehim në Qendër. Kërkesa 5. Lirimi i pagesës për mamografi dhe mamografia të bëhet çdo ditë pune. Qëllimi jonë është që mos të ketë pritje të gjata të termineve kur mamografi mund të punoj. Në Asambelën e ardhshme ne si grup i grave kemi me inicuar një projekt-propozim që mamografia të bëhet pa pagesë. Kërkesa 6. Rritja e buxhetit për Hendikos-in. Për shkak të rritjes së objektivit dhe nevojave, me ç'rast pritet edhe rritja e numrit të kërkesave për fëmijë, rritja e derivative. Kërkesa 7. Programi i veqantë i banimit. Qëllimi jonë është që të rritet numri i përfituesve nga ky program, pra bonus-banimit. Ne si grup i grave përtej partive politike që përfaqësojmë, zotohemi që do të mbështesim këtë projekt-buxhet, nëse rekomandimet tona kanë gjetë hapsira ligjore apo buxhetore për planifikim të buxhetit në vitin e ardhshëm.

Liridon Fandaj - ky projekt vendim për buxhetin e Komunës për vitin 2023 është sjell duke mos i përmbushur obligimet ligjore. E kam potencu edhe në KPF dhe ti si Kryesues i KPF-së je i obliguar me mbajtë dëgjime publike dhe një gjë të tillë nuk e ke bërë. Andaj vërejtjet në dëgjime publike dhe kërkesat e qytetarëve asnjëra nuk janë marrë parasysh. Ky buxhet është buxhet i Kryetarit por jo i qytetarit.

Laureta Tafaj - Pyetje për Drejtorin e Financave. Si është bërë shpërndarja e buxhetit tek projektet kapitale? Pyetje Drejtorit të Urbanizimit. Ndërtimin e pullazeve dhe izolimin e objekteve kolektive, ju lutem a mund të më tregoni saktësisht se cilët janë këto objekte? Kërkesë nga qytetarët e fshatit Grejkoc. Në aneksin e rrugës "Safet Kicaj" disa qytetarë po ndihen të diskriminuar sepse janë të vetmit që nuk kanë as kanalizim e as rrugë të shtruar. Kryetar, për ti bindur qytetarët që rrugët e tyre nuk shtrohen vetëm tek votuesit e AAK-së, ashtu edhe si duhet të jetë, kërkoj nga ju që kjo rrugë të shtrohet.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit besoj se janë krijuar kushtet ligjore që ky buxhet të vijë në këtë seancë. Janë adresuar në bashkëpunim me qytetarët shqetësimet dhe në këtë buxhet janë prioritet kryesore të qytetarëve dhe natyrisht në emër të grupit e mbështesim këtë projekt-buxhet.

Dardan Berisha - Në thirrjen publike që iu kemi bërë qytetarëve të Komunës sonë për t'iu bashkuar dëgjimeve publike, gjithësesi në koordinim edhe me qytetarët që të japin idetë e tyre për prioritetet e fshatrave të tyre, kemi vërejtur që shumica e projekteve për vitin 2023 janë fizionuar në kornizën buxhetore për vitin 2023. Gjithëashtu në takimin e 6 tetorit, me anëtarët e KPF-së kemi patur vërejtjet tona në draft buxhetin që na është ofruar, sidomos vërejtjet kanë qenë në specifikimin e projekteve kapitale e disa vërejtje tjera të cilat në këtë draft janë përmirësuar. Draft Korniza Buxhetore është dokumenti më i rëndësishëm sa i përket realizimit të projekteve kapitale, ku dihet që për vitin 2023 buxheti ka rritje afro 2

milion euro në krahasim me vitet që po i lëm pas. Andaj ky dokument nuk duhet të shihet si një projekt politikë, por detyrim i përgjegjësisë së punës në interes të qytetarv. 19.807.625 janë taksa të qytetarëve të Suharekës dhe jo të subjekteve politike. Për këtë arsye duhet që përkushtimi jonë si asambleistë të fokusohet në realizimin dhe implementimin e këtyre projekteve .Shumë projekte kapitale rrugore: Ndërtimi i sallave sportive dhe tereneve sportive, ndërtimi i QMF-ve të reja, automjete transporti për dializë, ndërtimi i zonave infrastrukturore të menqura Smart, ndërtimi i sistemit të ujitjes për bujq dhe qindra projekt tjera për bujqësi, ndërtimi shtëpive të kultures në Mushtisht, Samadrexhë dhe Studenqan, anekse shkollore e mijëra projekte tjera janë një tregues i sinqertë që buxheti duhet të kaojë. Në këtë rast grupi PDK-së është pro këtij vendimi.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit, Po ndalem te investimet kapitale nga lokaliteti ku vijë unë. Rruga “Zaim Muqa” dhe “Reshat Muqa” që e përshkon fshatin përgjatë gjithë fshatit, aty duhet një trotuar. Njëra anë e rrugës ka trotuar por duhet në anën tjetër trotuar. Mirëpo prioritet për fshatin Vraniq është rruga “Dyrrah”. Ajo rrugë duhet të ndërtohet pasi ajo rrugë kërkon një mur mbrojtës. Kërkoj që të inkorporohet në këtë projekt-buxhet për vitin e ardhshëm edhe kjo rrugë. Rrugës së Martirëve i duhet një trotuar. Pra prioritet janë këto dhe kërkoj që të inkorporohen në këtë projekt buxhet, sepse janë më se të nevojshme për fshatin Vraniq.

Kryetari - përshëndet të pranishmit. Sot është një ditë me rëndësi për qytetarët e Komunës së Therandës për arsye se po kalojmë një buxhet i cili ka mu punu për vitin e ardhshëm. Unë i kuptoj plotësisht kolegët pa dallim politik. Sa i përket pyetjes së Dr. Shefket Kolgecit, vitin e kaluar e kam pas një takim dhe është e vërtetë që disa qytetarë kanë shtrur asfalt, por aty duhet mi marrë disa prona dhe duhet mu rregullu muri mbrojtës, mirëpo kemi problem me prona për mu lidh me urën. Tjetri asambleist e përmendi problemin e ujit për fshatin Vraniq. Ne kemi një kompani publike që është Hidro Regjioni dhe duhet me ia dorëzuar atyre për me rregullu ujin në Vraniq. Asnjëherë s’kam premtu në fushatë që ka me rregullu punën e ujit në Vraniq. E përmendët Dragaqinën dhe impiantet e ujrave atmosferike. Asnjë projekt nuk varet nga Komuna sepse janë projekte të mëdhaja. Dragaqina veq është në projekt, dhe ma kanë dhënë fjalën që kanë me kry. Ai projekt është edhe për Komunën e Mamushës dhe Malishevës. Me impiantet e ujrave atmosferike kemi fillu. E kemi përfundu në Bukosh dhe vitin e ardhshëm e kemi në Dubravë, mirëpo impianti që kemi planifiku në Njëpërbisht, vlera është rreth 20 milion euro dhe nuk kemi mundësi me buxhet të Komunës. Çdo kërkesë e grupit parlamentar të gjinisë femërore që ka ardhë e kemi aprovu vazhdimisht. E kemi rrit buxhetin të Hendikos-i, kemi bo edhe shumë punë. E kemi një objekt shumë të mire por kemi një donacion rreth 300 mijë euro për ndërtimin e objektit për fëmijët me sindrom Down dhe Autizëm. Sa i përket infrastrukturës, ju e dini që buxheti është liru në muajin maj për këtë vit. Ne kemi nënshkru kontrata dy vjeqare dhe ju garantoj që ato mjete që janë përcaktu nëpër fshatra, kanë me shku po në ato fshatra. Te emërtimi i rrugëve, rruga në Gjinoc “Sherif Aga” është aneks, ku ajo rrugë në të ardhmen do të lidhet me fshatin Grejkoc. Rruga në Luzhnicë është aneks dhe ka me u vazhdu. Suka më pat thënë para dy muajve që mos bën propaganda dhe dezinformata me shkollë. Shkolla në Samadrexhë ka fillu. Ka mu nis edhe shkolla 7 Marsi, kanë mu nis edhe sallat sportive dhe të gjitha kanë me përfundu. Te shkolla në fshatin Reqan keni humb ju dhe ne, 200 mijë euro donacion për shkak të pronës sepse prona është në emër të Kishës. Shkolla në Reshtan është kontest, dhe sa i përket shkollës në fshatin Maqitevë, e ka marrë obligim drejtori. Ne kemi pas takim me ministren e Arsimit, jemi dakordu dhe të shohim a po e mbajnë fjalën. Sa i përket stadiumit, nuk kam rrejt, por stadiumi nuk bohet me parë të Komunës, por stadiumi dhe sallat sportive do të bëhen. Kryetari falemderon Ministrat për donacionet dhe investimet që janë bërë në Komunën tonë. Selman, nuk është kthy përgjigjgjja ende, s’e kemi vijën e gjelbër për me shpall tenderin për shtëpinë e Kultures. Buxheti që është i paraparë për vitin e ardhshëm, unë ju garantoj që më së paku edhe 50 % ka mu shtu dhe ka me pas investime të reja.

Selman Kolgeci - e di që problemi mes Budakovës dhe Vraniqit është i madh. Por unë thash që për prioritetin e parë nevojitet investim në sanimin e defekteve në kaptazha mbledhëse. Te shtëpia e kulturës, a keni me vazhdu me buxhet tonin? Nëse keni me vazhdu me buxhet të ministries, pse nuk keni nda edhe pak buxhet ju?

Kryetari - i kemi 3.1 milion euro për shtëpinë e Kulturës dhe nuk kem nevojë me nda fond.Mjete ndajmë çdo vit për me shtu sasinë e ujit,nuk i shpallim tenderat ne,por e kemi një memorandum me Hidro Regjionin.

Selman Kolgeci - Nëse i ka 3.1 milion,ku janë ato?

Kryetari - 3.1 milion janë në bankë.

Urim Suka - adresimet që Kryetari bëri nga shqetësimet që ne patëm janë për keqardhje sikur që është buxheti për keqardhje.Dragaqina nuk varet prej Komunës,është projekt i madh,tha Kryetari.Por ti përditë e përmend si projekt tëndin.Impiantet the që nuk ke mundësi mi bo me buxhet të Komunës.Çka e ke fut në strategji pasi s'ke mundësi?Për disa shqetësime që unë ngrita,tha: kontratat janë dy vjeqare.Kontrata në Mushtisht kurkund nuk shkrun që është dy vjeqare.Kontrata e rrugës Sherif Aga,askund nuk shkrun që është aneks.Në Luzhnicë e njejta situatë.Për shkollën në Reqan,nëse ajo pronë s'po bëjka,gjeje një pronë dhe rregulloje ose meremetoje.Ke thënë,kemi me bo stadiumin e qytetit.Cili është kontributi yt për stadiumin e qytetit?Unë nuk jam tu e analizu buxhetin e ministrisë,federatës dhe uefas.Unë jam tu e analizu buxhetin e Komunës së Suharekës,ato që ti zotohesh dhe ti bën dhe është përgjegjësi e jotja.Nuk më dhe përgjegje për kullën Ramë Bllaca,për urën në Bllacë e për disa projekte tjera.

Qëndrim Elshani - përsëndet të pranishmit.Sa i përket buxhetit kam shumë kritika,por kryesisht u thane nga kolegët asambleist.Dua të ndalem vetëm te një pikë që e tha Kryetari.Kryetari falemderoi ministrat e zëdhënës ministrant.Në rregull,po e pranojmë krejt që po punohet,sikur që është ndërtimi i rrugës Baqevc-sallagrazhdë-Greikoc-Malësi e Re,por Kryetarit sot i ra ndërmën me falemderu ministrin e zëdhënës ministrin e infrastruktures.Mirëpo si kritikë,Kryetarit duhet me ja thënë,që duhet ti bie ndërmend edhe nëpër rrjete sociale me i falemderu dhe me i tregu investimi i kujt është dhe jo me i marrë, me i përvetësu meritat për vete.

Kryetari - rruga Baqevc-Sallagrazhd-Greiqec ka qenë e kontraktune dhe u ndërpre vitin e kaluar.Rruga për Novak ka qenë e kontraktuar dhe u ndërpre vitin e kaluar.Rezervuari i ujit ,ka qenë i shpalluar tenderi dhe është anulë.Shtrati i lumit që vazhdimisht kemi pas vërshime është anulë.Këto mjete nuk janë as të qeverisë,as të kryetarit por janë të popullit.Atë që e kam premtu,ka me realizu.Shkolla në Reqan është renovu,edhe shkolla në Reshtan.

Kushtrim Kuçi - shqetësimi i qytetarëve është për rrugën Skënderbeu.Çka do të veproni në këtë rast?Nga ana profesionale e pëlqej zgjerimin e rrugëve,mirëpo a ja vlen që për 10 ditë ose dy javë me i shkatërru 40 biznese ?

Kryetari - nuk është problem i 40 biznesev,por është problem i 3 bizneseve dhe është në Plan Komunal,është në Plan Zhvillimor,në Harta Zonale,paret janë planifiku dhe në moment që kryhen procedurat,vazhdojmë me rrugën.

Liridon Fandaj - nëse ke një vendim të Ministrisë që ajo rrugë nuk është në kompetencën tënde,atëherë,ti a po punon kundër Qeverisë apo si është puna?

Kryetari - unë zbatoj Kushtetutën e vendit dhe ligjet që janë në fuqi.

Lirodon Fandaj - ai vendim, a nuk është i ligjshëm?

Kryetari - unë nuk thashë, as s'është i ligjshëm,as i pa ligjshëm.Unë vetëm zbatoj Kushtetutën dhe ligjet që janë në fuqi.

Shefket Kolgeci - Kryetar, kam propozim rreth rrugës së Dyrrahit.Thatë që ka pengesa pronësore.Unë kisha kërkun nga ju dhe Drejtoria e Urbanizmit që të mbani një takim së shpejti dhe të shkoni në atë vend-lokacion dhe të merremi vesh,sepse mendoj që kemi me bo zgjidhje.

Kryetari - unë ju garantoj që kemi me ju thirrë por s'keni me ardhë.

Labinot Halitjaha - përsëndet të pranishmit.Ndoshta nuk jemi të përkryer në punimin e dokumentit por 95 % është në rregull.Buxheti i vitit 2023 është më i lartë se i viti 2022,afërsisht 2.686.000 euro.Investimet kapitale janë nda në bazë të banorëve dhe në bazë të kërkesave të qytetarëve .

Laureta Tafaj - në bazë të kërkesave të qytetarëve,të paktën kjo nuk është.Në Greikoc ka 5 vjet që kërkojnë një trotuar,mirëpo ajo kurrë nuk po ndodh e në bazë të kërkesave tjera ,ndoshta.

Liridon Fandaj - drejtor,the që projektet kapitale janë shpërnda në bazë të numrit të banorëve.A e ke bo ti këtë shpërndarje,apo e ka bo Kryetari?S'e di sa banorë i ka Semetishti me Peqanin.Kërkoj sqarim.

Labinot Halitjaha - te ndarja e 20 mijë euroshit në Peqan,aty i kemi nda edhe disa mjete për rrugën Peqan-Semetisht.

Liridon Fandaj - por në dëgjim publik keni thënë 40 mijë euro.

Shefket Kolgeci - dua të di nga qeveria,këto vërejtjet që bëmë ne,a do të inkorporohen në këtë buxhet?

Kryetari - jo,është e kryer.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

**17 për,11 kundër,1 apstenim
Miratohet pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi” ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Laureta Tafaj - cilat kanë qenë kriteret për me u vlerësu për çmimin “Ukë Bytyçi” ?

Kryetari - është një kriter që me vite vazhdon, konkursi ka qenë i hapur dhe ne kemi zbatu rregulloren.

Urim Suka- në emër të grupit parlamentar theksoj që çmimi “Ukë Bytyçi” është një simbolikë e mire që duhet të vazhdohet,që njerëzit që kanë suksese të mbështetën.Sukseset e Ballkanit janë përtej Komunës dhe përtej Kosovës dhe kjo na bënë krenar edhe neve.Ky projekt -vendim do ta ketë edhe përkrahjen tonë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë,hap debatin dhe kërkon emrat për anëtarët e komisionit.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit tonë, ne propozojmë Herolind Limaj.

Urim Suka - në emër të grupit të LDK-së,propozojmë Kushtrim Kuçi.

Liridon Fandaj - në emër të LVV-së propozojmë Laureta Tafaj.

Kryetari - pasi duhen vetëm dy emra nga Asambleja për këtë komision,kërkoj me mirëkuptim nga Herolind Limaj që të tërhiqet.Nga ekzekutivi propozoj Armend Krasniqi dhe Besa Kuçi dhe nga shoqëria civile Aida Kuçi.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje:Kushtrim Kuçi,Laureta Tafaj,Armend Krasniqi, Besa Kuçi dhe Aida Kuçi.

Miratohet Unanimisht

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës-2022-2030 (HZK);

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - përshëndet të pranishmit.Afërsisht tash një vit,Asamblenë e 10-të të vitit të kaluar ishte një kërkesë e imja për lagjen Gradina në Suharekë.Iniciativa ime ishte që të miratohet kërkesa e pronarëve, e aprovuar nga ekipi komunal për planifikim, ndërtimi me shumë njesi banesore dhe afarizëm ZSHP5 si zone e parë e cila është aprovuar dhe shpallur dhe në faqen e Komunës.Kjo është aprovuar dhe në Asamble në PZHK,por në HZK nuk figuron.Me që kam disa informata që HZK duhet të bazohet në PZHK, kërkoj që nëse është gabim teknik apo anashkalim apo gabim me paramendim,të futet ky ndryshim dhe me këtë ndryshim unë mendoj që do ta votoj këtë pikë të rendit të ditës.

Sanie Kuçi Rexhepaj - te pjesa e listës së kontribuesve në projekt për HZK-në,në pjesën tekstuale, mbiemri të azhurohet me Sanie Kuçi Rexhepaj.Dokumentit më të rëndësishëm planifikues menjëherë pas

PZHK-së po i jepet mundësia për diskutim dhe aprovim final. Dokument më se i nevojshëm në këtë kohë duke marrë parasysh që dokumentet që tashme janë në fuqi datojnë që nga viti 2008, dhe që nga ajo kohë gjendja në teren ka ndryshu shumë. Ka ndryshu gjendja kadastrale, kanë ndryshu kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. E ky dokument do t'ia lehtësoj punën edhe zyrtarëve komunal, që përmes këtij dokumenti të shqyrtojnë në kohë sa më të shpejtë dhe me korrektësi kërkesat e qytetarëve. Do t'ia lehtësojë punën edhe kompanive projektuese të cilave do ti mundësohet që përmes këtij dokumenti ti kenë pothuaj të gjitha kriteret dhe kushtet për projektim të objekteve dhe planifikim të hapësirës. Dokument më se i nevojshëm duke marrë parasysh që Komuna e Suharekës ka plane rregulluese të hollësishme të pezulluara nga ana e ministrisë dhe që nga ajo kohë Komunës iu është pamundësu zbatimi i tyre duke marrë parasysh që për këtë çështje Komuna është në gjykatë me ministrinë. E duke marrë parasysh të gjitha këto ndryshime e pengesa me të cilat Komuna po ballafaqohet çdo ditë e gjithëashtu edhe qytetarët, miratimi i një dokumenti të tillë që në përgjithësi i zgjidh këto çështje është më se i nevojshëm. Unë do të doja që të ndalem pak më shumë në përmbajtjen dhe interesat e përgjithshme të komunës, jo në interesa individuale. Por në anën tjetër ky dokument përpos që hartohet për interesa të përgjithshme të Komunës, ka për qëllim me iu shërby të gjithë qytetarëve pa dallim. Andaj është e pamundur pa u ndal në kërkesa apo ankesa specifike të qytetarëve, ku ne si asambleist i përfaqësojmë ata dhe jemi zotu që do ti mbrojmë të drejtat dhe kërkesat e tyre. Shqetësimin që shprehu Bulëza e dëgjova me vëmendje dhe e kam pranë edhe unë, dhe meqenëse kam qenë pjesë e ekipit të PZHK-së e cila është miratru mandatin e kalum, më duket më se e nevojshme që edhe kësaj Asambleje të këtij mandati me ju dhanë një sqarim. Kërkesën që e ceki Bulëza është konkretisht kërkesa nga Unicomi për parcelën 2885-1/ZK Suharekë dhe kërkesa nga Rexhep Kuçi si përfaqësues i pronarëve të tokave për parcelën 2361-1/ZK Suharekë në fazën e dytë të shqyrtimit publik të PZHK-së. Këtë çështje e kemi ngrit me Bulëzën edhe në KPF. Ky shqetësim është ngrit edhe në mbledhjen kur është votu PZHK 2021-2029. Kjo pasi që kërkesa e pronarëve të tokave dhe përfaqësuesëve të pronarëve të tokave në atë kohë ka kalu nga ekipi Komunal për Planifikim dhe këshilli i ekspertave, por që nuk ka qenë totalisht e azhurume në data bazën e PZHK-së. Në atë kohë si drejtoreshë e kam marrë fjalën dhe jam zotu që ajo kërkesë do të azhurohet. Asambleja mandatin e kalum e ka aprovu PZHK-në 2021-2029 me atë plotësim- ndryshim. Pas miratimit të PZHK-së, Komuna ka qenë e obliguar që çdo dokument tjetër që është duke u hartu, ta harmonizojë me PZHK-në, përfshirë edhe Projekt Hartën Zonale të Komunës. Në këtë fazë që jemi, përpara nesh e kemi një dokument që kërkohet të miratohet por në anën tjetër kemi shqetësim të qytetarëve që kërkesa e tyre e aprovuar në PZHK, përveq që nuk është azhuru në HZK, as nuk është marrë për bazë, por është refuzu si ankesë në fazën e shqyrtimit publik të HZK-së. Andaj kërkoj nga Drejtoria, konkretisht Drejtori i Urbanizmit që të na jap më shumë sqarime se a është ky dokument, Projekt Harta Zonale e Komunës e harmonizuar me Planinin Zhvillimor Komunal në fuqi dhe nëse shqetësimet e qytetarëve, konkretisht pronarëve të atyre tokave të asaj zone qëndrojnë, të na ofrojë zgjidhje konkrete rreth kësaj çështje.

Kryesuesi - e elaborove ashtu si ka qenë, sepse kur është votu PZHK, është votu pikërisht me këtë shqetësim që e ka ngrit Bulëza Kuçi, ku edhe është marrë për bazë kërkesa e Bulëzës të futet në PZHK. Sa e pash kërkesa ishte e Taulant Hashim Kuçit dhe të ndjerit Rexhep Kuçi, dhe është votu vendimi me këtë ndryshim që të futen edhe këto dyja në PZHK. Se si ka rrjedh pastaj nuk e dim, mirëpo kërkoj që të futen në Harta Zonale të Komunës.

Selman Kolgeci - sa i përket kësaj pike vlen me përsëritje punën e zyrtarëve, Drejtorisë së Urbaizmit të cilët janë angazhu që ky dokument të merr formë e të bëhet i gatshëm për miratim. Siq e dini, ne i kemi dhënë mbështetjen tonë që ky dokument ti nështrohet diskutimit publik, dhe përtej mbështetjes me votë ishim të gatshëm që të japim kontributin tonë edhe për diskutim të ndarë në zona dhe monitorim të shqyrtimeve publike. Në mënyrë që ky dokument i rëndësishëm i PZHK-së të jetë sa më gjithëpërfshirës, ne me qëllimin më të mirë kishim propozuar për zgjatje të afatit të shqyrtimit publik edhe për 15 ditë tjera. Një gjë e tillë nuk e kishte marrë mbështetjen nga asambleistët e kualicionit qeverisës. Gjatë analizimit të materialit, konkretisht për këtë pikë të rendit të ditës kam vërejt se në nenin 2.2 shenon: Harta Zonale e Komunës së Suharekës për periudhën kohore 2022-2030 përmban pjesën tekstuale dhe grafike, raportin e vlerësimit strategjik mjedisor, planin e monitorimit dhe raportin e shqyrtimit publik. Në kopje fizike dhe digjitale janë pjesë përbërëse të këtij vendimi, ndërsa në materialin e

përcjellë për këtë seancë mungonte shumica e pjesës garfike dhe raporti i shqyrtimit publik.Për të njejtat,gjatë javës së kaluar kam kërkuar që të na dërgohet e të plotësohet materiali për këtë seancë,dhe atë raporti i shqyrtimit publik,harta e infrastrukturës publike dhe sociale,harta e infrastrukturës teknike,harta e shfrytëzimit të tokës bujqësore.Me datë 26.09.2022 kam pranuar një email ku pretendohet se na është plotësuar materiali,ndërsa gjatë shfletimit kam kuptur që për shkarkimin e këtyre dokumentacioneve duhet edhe një aprovim shtesë.E tëra kjo në ditën e fundit.Megjithatë e pash që në raport të shqyrtimit publik po mungojnë përgjigjet për qytetarët që ankesat e tyre i kanë adresuar në emailin e Komunës,edhe pse adresimi i tillë ka qenë i lejuar.Për këtë kërkoj sqarim nga Drejtori i Urbanizimit.Nuk e kam të qartë se pse materiali dje më është përcjell vetëm mua.Poashtu disa nga ankesat janë aprovuar ku po shihet që është rrit etazhiteti,e disa nga ankesat janë refuzuar.Si pasojë e kohës shumë të shkurt për ta analizuar materialin,nuk kam arrit që të analizoj të gjitha ankesat dhe ne akoma nuk e dim nëse ju i keni trajtuar të gjitha ankesat në mënyrë të barabartë. Mendoj që ndryshimet që kanë ndodhur pas ankesave duhet të jenë transparente dhe për këto ndryshime duhet të njoftoheshin anëtarët e kuvendit e jo kjo gjë të kalojë në heshtje,sepse po më jep përshtypje që kemi të bëjmë me një tentim të komntrabandimit të dokumentit më të rëndësishë të Planifikimit Hapsinor dhe një tentim të shkeljes së dinjitetit të asambleistit.Mendoj që do të ishte mire që kjo seancë mos të përfundoj sot dhe për këtë pikë të rendit të ditës ta shtyejmë për një ditë tjetër gjatë kësaj jave,në mënyrë që këtë material ta kenë gjithë anëtarët e Kuvendit dhe ta analizojnë secili veq e veq.Parimisht jam për miratimin e këtij dokumenti,mirëpo në një datë tjetër.

Dardan Berisha - Përveq draftë- dokumentit të buxhetit që është i rëndësishëm ,unë mendoj edhe që Hartat Zonale të Komunës 2022-2030 janë një ndër dokumentet ma të rëndësishme të K. Suharekës.Qysh prej legjislaturës së kaluar kur kanë fillu edhe dëgjimet publike,ne kemi qenë pro,duke falemderuar në mënyrë të veqantë një nga një gjithë anëtarët e komisionit.Ne si grup i Asambleistëve jemi pro.

Laureta Tafaj - unë pata një kërkesë e cila është pothuaj e njejtë me kolegun parafolës,për me lënë javën e ardhshme ose kurdo që të bëhet gati plani zhvillimor me ato ndryshime në Harta Zonale.

Kryesuesi - ne mund ta votojmë me ndryshim.

Qëndrim Elshani - sa i përket votimit me ndryshim,kërkoj nga zyrtari ligjor me na tregu se a është e ligjshme kjo apo jo.

Avni Bytyqi - Harta Zonale e Komunës e ka një bazë ligjore si dhe një dokument paraprak e cila duhet të bazohet dhe mbi bazën e asaj edhe të hartohet nga ekspertë të fushave të caktuara,konkretisht nga autoriteti përgjegjës komunal i Komunës.HZK bazohet në aktivitet zhvillimore e hapsinore të cilat rrjedhin apo burojnë nga plani zhvillimor komunal,përkatësisht nga hartat e shfrytëzimit të tokave,plani zhvillimor sektoral dhe planet e veprimit të asaj zone.E nga kjo kuptojmë që HZK duhet të jenë në harmoni dhe përpuethshmëri me PZHK-në pa ia cenuar të drejtat askujt.Planifikimin dhe miratimin e planeve hapsinore ekskluzivisht në bazë të ligjit për vetqeverisje lokale dhe ligjit të Planifikimit Hapsinor si dhe një varg udhëzimesh administrative është ekskluzivisht kompetencë e Komunës që ti harton në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës komunal për Planifikim Hapsinor dhe të miratohen nga Kuvendi i Komunës.Nëse gjatë diskutimeve konstatojnë apo dyshojnë se HZK apo një pjesë e HZK-së nuk është në harmoni dhe në përpuethshmëri me PZHK-në,atëherë autoriteti përgjegjës,Drejtoria për Planifikim e Komunës duhet të jepë sqarime dhe rekomandime se si një gjë e tillë ka ndodhur dhe a duhet të inkorporohet në kuadër të PZHK-ë ajo pjesë e HZK-së që nuk është në përpuethshmëri me PZHK-në.Pra çështja e miratimit është kompetencë e Kuvendit.Nëse një gjë e tillë ndodh në plotësim-ndryshim të Hartës Zonale,Drejtoria e Urbanizimit ka për obligim që ta paraqet një raport të detajuar dhe ta dërgon në MAPL dhe ti jep sqarimet e bazuara me qëllim që të pranohet edhe në MAPL plotësim-ndryshimi dhe që është në harmoni dhe përpuethshmëri me PZHK-në.

Visar Kuçi - Selman, unë e kam pranuar një email nga ju,ku në fakt e ke dërgu të premtën dhe unë dje e kam pa.Me të marrë emailin të kam kontakti dhe ti kemi përcjellë edhe hartat,edhe pse këto harta nuk kanë ndryshim të madh nga drafti që është i publikuar në faqe të Komunës dhe është dërgu te secili asambleist.Kur e kemi dërgu materialin te zyrtari ligjor, për shkak të volumit të madh të materialit ia kemi sqaruar zyrtarit se çdo asambleist që ka nevojë për hartat tjera le të drejtohet te ne.Ne ia kemi dërgu pjesën tekstuale bashkë me hartat e shfrytëzimit të tokës ku më shumë iu ka shërby ajo,sepse në këtë procedurë

ndryshime ka pas vetëm në ndërrim të etazhitetit apo ndryshim të rrugëve ,ndërsa në pjesë tjera nuk ka pas ndryshime në hartat e kaluara.

Selman Kolgeci - e vërteta është që unë të enjten e kam përcjell emailin te ju z.Kuçi dhe Z. Bytyqi dhe mandej ju e keni përcjell emailin te Drejtori i Urbanizmit dhe mua dje më është kthyer emaili.

Ju po e pranoni që ka ndryshime në ato harta,atëherë dërgoja të gjithëve.

Visar Kuçi - aty ku ka ndryshime ti kemi dërgu.Ndryshimet janë vetëm në hartën e shfrytëzimit të tokës në shqyrtim publik.Ndryshimet janë te ndërrimi,shtimi i etazhitetit dhe largimi i rrugëve apo shtimi i rrugëve.

Selman Kolgeci - ne nuk dimë kujt iu ka kthy ankesa pozitive dhe kujt negative.A keni përdor standarte të dyfishta te ata?Për atë kërkova me shty, që të jenë të informuar secili asambleist.Unë jam për me miratu por le ta ken informatën të gjithë dhe le të inkorporohet edhe rasti i Bulëzës si tha edhe Drejtoresha që duhet të inkorporohet.

Avni Bytyqi - këtë projekt-vendim që ju keni para vetes,unë e kam hartu dhe dispozita 2.2 e jep kuptimin që pas miratimit të këtij vendimi,këto dokumente janë bazë dhe për të cilat ky vendim duhet edhe të orientohet me qëllim që të lëshohen kushtet dhe kriteret për leje të ndërtimit që janë të planifikuara në kuadër të atij dokumenti.Edhe kur është miratu PZHK e kemi pas të njejtin problem,që emaili nuk i përmban gjithë këto dokumente.Në material shkruan që të gjithë ata që janë të interesuar që të kompletojnë materialin dhe që kanë nevojë për ta analizu,të vin tek drejtorja e Urbanizmit dhe ta marrin,sepse nuk ka mundësi dhe kapacitet emaili me dërgu gjithë këtë material voluminoz.Është e vërtetë që e ke dërgu një email të enjten në adresën time dhe të Kryesuesit.Unë menjëherë e kam adresu te organi kompetent me qëllim që me adresu,mirëpo e keqja është që nuk e ke dorëzu në emër të gjithë anëtarëve të kuvendit por e ke dorëzu vetëm në emrin tend personal dhe drejtorja me vonesë apo pa vonesë tu ka drejtu ty dhe ta ka dërgu.

Urim Suka - Për derisa është situatë kështu,ne po themi që qytetarëve me ia dhënë një dokument sa ma të mirë dhe për këtë ne duhet ta dime për çka po votojmë.Për me ditë për çka po votojmë duhet me u kompletu me material,pastaj me analizu në detaje dhe me pas një qëndrim të prerë.Kërkesën që e pat Bulëza,edhe ne jemi pro,por këtu ka edhe kërkesa tjera që nuk dim as si janë trajtu.Merrne propozimin e Selmanit si të mirëqen në mënyrë që secili asambleiat ta shqyrtojë këtë material sa ma mirë.

Avni Bytyqi - te çështja e plotësim-ndryshimit të HZK-së të keni parasysh,u ngrit një çështje nga Sania që unë e vlerësoj sepse është eksperte e kësaj fushe dhe ka qenë pjesë PZHK-së por edhe e HZK-së.Nëse vërtetë qëndron ajo që u tha,që në kuadër të PZHK-së është e miratuar dhe e inkorporuar kërkesa e Bulëzës që është ngrit në PZHK,atëherë duhet ta analizojnë këtë çështje ekspertë të fushës së caktuar se a është në kuadër të PZHK-së.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime dhe rekomandon që Drejtorja e Urbanizmit dhe ekspert që janë mbrapa të japin sqarime se a ekziston në kuadër të PZHK-së kjo çështje që ju pe ngritni e pastaj të vazhdohet me plotësim-ndryshim të Hartës Zonale.

Qëndrim Elshani - kërkoj përgjigje prej Drejtorit të Urbanizmit se a u shqyrtu kjo kërkesë që paraqiti Bulëza?

Visar Kuçi - gjatë shqyrtimit 30 ditësh,ne kemi pas 139 kërkesa, kemi pas mbi 500 qytetar që na kanë vizitu në D.Urbanizmit,ku janë njoftu me pronat e tyre se çfarë destinimi kanë.Prej 139 kërkesave,6 kanë qenë të njejtja,41 janë aprovu,26 janë aprovu pjesërisht dhe 68 janë refuzu.Në mesin e këtyre kërkesave ka qenë edhe kërkesa e Unicom.Kanë qenë dy kërkesa,ku njëra kërkesë ka qenë në emër të Unicom dhe një kërkesë në emër të Burim Elshanit.Kërkesën e Burimit ekipi komunal dhe këshilli i ekspertave e ka aprovu,kurse kërkesa e Unicom është refuzu.Te kjo pjesë nuk kam has në gabim teknik,unë e kam gjet ashtu.Nëse është gabim teknikë,te secila parcelë,te secila zone,te secili bllok,ne e kemi të drejtën ta përmirësojmë nëse është bo gabim gjatë procesit.Kemi pas përmirësime edhe në vendimet e fundit që kemi marrë.Drejtori tutje jep sqarime sa i përket Pyetjes së Selmanit për email.

Bulëza Kuçi - unë nuk mora përgjigje të detajuar dhe specifike nga Dejtori.Unë e ceka që kërkesa ime është aprovu dhe ka kalu në Asamble.Kjo është ose gabim teknik ose me paramendim.Nëse është gabim teknik,pranoje dhe merri procesverbalet dhe hetoje rastin.Nëse është me paramendim,atëherë duhet me hetu rastin dhe me pa çka ka ndodh.Kërkoj sqarim më të detajuar. A do të azhurohet,a ka me hy dhe kur ka me hy?

Visar Kuçi - unë po them që s'kam has në këtë problem dhe nëse është gabim teknik të premtoj që ka me u përmirësu,sepse e kemi obligim ligjor.

Bulëza Kuçi - sipas teje si mendon,a duhet me kalu me këtë vërejtje apo mos me kalu?

Visar Kuçi - vendimi i ka dy gjana,o kalon vendimi siq është i përgaditur ose nuk kalon.Le të drejtohet pala, ose ti si asambleiste drejtoju Drejtorisë së Urbanizmit.Nëse është gabim teknik ka me ju përmirësu.

Flamur Bytyqi - nëse këta kanë bo ankesë më herët,a e keni shqyrtu ankesën e tyre?

Visar Kuçi - nuk kemi has në të kaluarën se ka qenë ZSHP5.

Bulëza Kuçi - nuk është hera e parë që ne dy po e diskutojmë këtë temë.

Visar Kuçi - binduni që nuk është diçka e qëllimshme.

Flamur Bytyqi - nëse ka qenë gabim,nëse këta e kanë prurë ankesën,ju e keni shiku besoj procesverbalin.

Visar Kuçi - sot lindi një problem tjetër që në të kaluarën ka qenë ZSHP5.Materialet e mëherëshme,në kohën kur ka qenë ish Drejtoresh Sania,nuk i kam pa.Unë i kam marrë materialet prej se e kam marrë detyrën dhe i kam pranuar materialet nga kompania dhe nga Ministria.

Sanie Kuçi Rexhepaj - edhe në mbledhjen e KPF-së e kam shpreh si shqetësim mungesën e drejtorëve në atë takim.Nëse Drejtori i Urbanizmit ose përfaqësues të asaj drejtorie kishin me qenë pjesë e takimit ku unë dhe Bulëza e kemi ngrit si çështje,Drejtori në këtë mbledhje kish me qenë më i përgaditur dhe kish me i analizu komplet dokumentet e PZHK-së që janë miratu nga mandati i kalum i Asamblesë Komunale.Atëherë unë po e hapi raportin e shqyrtimit publik të PZHK-së- faza e dytë dhe po e lexoj kërkesën konkrete nga pala që e ngritem si çështje dhe po i tregoj Drejtorit se në cilin dokument mundesh me gjetë përgjigjen e saktë.Kërkesa nga Unicom i kërkon: kërkoj që parcela nga destinimi pjesërisht banim individual dhe zonë rekreative, të shëndrrohet në Zonë për shfrytëzim të përzier ZSHP Zonë e pare.Për arsye të zgjerimit të banimit kolektiv,mundësi zhvillimi të hotelarisë,zhvillimi i zonës etj.Kërkesa e palës është aprovu nga ekipi komunal për planifikim dhe këshilli i ekspertave.Nëse e shohim hartën e shfrytëzimit të tokës,e shohim që kjo zonë për të cilën po flas,është ZSHP3 dhe jo zonë e parë.D.m.th. kërkesa që është miratu në PZHK nuk është azhuru apo harmonizu HZK me PZHK-në.Është e vërtetë që PZHK është shumë strategjik në hartat që janë të ruajtura në PDF dhe janë të printuara,dhe i cakton vetëm zonat për shfrytëzim të përzier.Por nëse e hap Data Bazën e PZHK-së dhe e prek secilën parcelë,janë informatat në detaje në secilën zonë.Nëse shkon te parcela për të cilën po flasim,e shoh që në atë zonë në PZHK është ZSHP5.Të ftoj ta kontrollosh.Ne nuk morëm zotim konkret nga ana e drejtorit.Nëse shkelen kërkesat e qytetarëve që janë aprovu nga ekipi dhe këshilli,mua më duket e padrejtë me u miratu ky dokument në këtë formë. Për zyrtarin ligjor -Te projekt-vendimi për miratimin e Hartës Zonale pika 2.2,mendoj që është mire me u përfshi që në HZK porpos dokumenteve që janë të shënuna,përmban edhe Data Bazën e të dhënave në formë digjitale.

Visar Kuçi - të njejtat gjëra që po i thoni ti dhe Bulëza,pi them edhe unë.Nëse është gabim teknik kjo ka me u përmirësu,por jo veq kjo,edhe të tjera.

Sanie Kuçi Rexhepaj - sa kohë zgjat shqyrtimi i dokumenteve për gabime teknike?

Visar Kuçi - do ti kontrolloj.Unë para tre jave e kam pas një gabim teknik dhe gjatë procesit e kam përmirësu.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ka qenë draft dhe tash po miratohet.

Visar Kuçi - kem të drejtë me përmirësu çdo here gabimin teknik.

Kryesuesi - jo,në moment që miratohet në Asamble kryhet.

Visar Kuçi - kemi të drejtë çdo moment me përmirësu gabimin teknik.

Qëndrim Elshani - kjo kërkesë është aprovu një here gjatë fazes së PZHK-së. Pse tash nuk është azhuru?Kur komisioni e aprovon,ajo duhet domosdo me qenë dhe në PZHK.Kjo nuk është një çështje që s'është diskutu,kjo është diskutu shumë dhe do të ishte mire me i marrë procesverbalet e mëherëshme gjatë shqyrtimit të PZHK-së,ku edhe shihet që ka kalu.

Urim Suka - jemi tu fol për dokumentin që është shumë serioz,ndërsa po shihet se sa serioz jeni ju në çasjen e këtij dokumenti dhe as komunikimet formale mes vete nuk i keni kry.Prandaj për shkak të paqartësive dhe gjërave që nuk janë trajtu deri në fund,kuptone propozimin që vje nga ne dhe shtyje për një periudhë të caktuar.

Driton Maliqaj - meqenëse disa prej neve jemi laik në këtë pjesë,dhe pasi kompania kontraktuese është e pranishme,kisha kërku një interpretim nga kompania dhe nga ekspertat e drejtorisë së Urbanizmit.Kisha kërku që ata të cilët janë pagu,me dal me dhanë interpretimin.

Visar Kuçi - ne nuk jemi duke mos u koordinu me Sanien,por po flasim për anën profesionale.

Selman Kolgeci - drejtori po thotë që raporti i shqyrtimit publik është i publikuar në faqe të Komunës.Ju duhet me ma dërgu materialin.Po thoni që ndryshimi në harta ka ndodh.Dërgoma atë ndryshim dhe ta shohin të gjithë asambleistat.

Kryesuesi - unë qëndroj pas saj që ne e kemi votu një projekt-vendim për PZHK-në. Është transkripti,janë inqizimet,është votu me ndryshim duke u bazu në kërkesën e Bulëzës që e ka parashtru në atë kohë dhe është votu. Ishte një kërkesë që seanca të shtyhet,mirëpo unë jam i pajtimit që ta përfundojmë sot.

Kryesuesi - e hedh në votim që Pika 5 të votohet sot me plotësim-ndryshim.

19 për

Kryesuesi - me 19 vota për u vendos që pika 5 të votohet sot me plotësim-ndryshim.

Qëndrim Elshani - kisha kërku një sqarim ligjor se a kemi të drejtë me votu.

Kryesuesi - për derisa vitin e kaluar e kemi votu një vendim me ndryshim për PZHK,edhe tash kemi të drejtë.

Qëndrim Elshani - me korigju, a kemi të drejtë?

Kryesuesi - e hedhim në votim Pikën 5 me ndryshim duke u bazuar në kërkesën Bulëzës dhe Sanies që në këtë projekt-vendim,në Harta Zonale të futet kjo pjesë në ZSHP5.

Avni Bytyqi - nëse këtë çështje që pe ngritni është në kuadër të Planit Zhvillimor, konstatohet nga ekspertë të fushës së caktuar që është në kuadër të PZHK-së, Harta Zonale mund të harmonizohet pas një raporti që bëhet nga Drejtoria e Urbanizmit dhe dërgohet në Ministri. Një raport i detaizuar mirë dhe i arsyeshëm nga drejtoria se pse ka ndodh një gjë e tillë dhe nëse nuk është në Hartën e PZHK-së, nuk besoj që Harta Zonale të jetë në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal.

**20 për, 2 Kundër,7 apstenime
Miratohet Pika 5 me ndryshime**

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interes të përgjithshëm publikë ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Kryetari - vetëm po e largojmë vetshërbimin që është në fshatin Sopijë sepse në katastrof del që është pronë private.Janë prona shoqërore dhe ato objekte kanë dalë prej përdorimit.Kemi kërkesë nga Qeveria që ne e kemi marrë një vendim ti shpronësojmë për nevoja të qytetarëve të Komunë sonë.

Urim Suka - ne fillimisht e mbështesim që këto prona me kalu në kuadër të Komunës.Ajo që pash në material,është se këtu te një pjesë shkruan shkolla fillore "Emin Duraku" Bllacë,e që realisht shkolla është "Ramë Bllaca".

Avni Bytyqi - këtë dokument ne e kemi hartu mbi bazën e dokumentave që i kemi nxjerr nga Drejtoria e Pronës,dhe prona që është në emër të ish shkollës "19 Nëntori"është qysh atëherë kur është regjistru,para lufte.Pas lufte,emri është ndryshu mirëpo nuk është azhuru te prona.Nuk besoj që ka naj pengesë ligjore.

Urim Suka - është mire që pjesën e emrit ta rregulloni.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i raportit vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditorit të brendshëm për periudhën janar-dhjetor 2021 ;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - dua ta pyes Drejtorin e Financave se a e ka shiku këtë raport dhe cilat janë vërejtjet që ky ka me marrë masa për me i përmirësu.

Labinot Halitjaha - po, e kam pa materialin edhe pse është pjesë e 2021-tës. Për vitin 2023, rekomandimet që muj mi marrë parasysh, ka shumë. Pjesën e rekomandimeve sidomos që i ka bo auditori i brendshëm, sivjet i kam implementu dhe besoj deri në fund të vitit shumicën kemi me i implementu.

Liridon Fandaj - kjo po i bie që auditori i jashtëm paska pas të drejtë, që keni keqmenaxhime, keqplanifikime.

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje

Shefket Kolgeci - kam kërkesë që të lexohet rregullorja se si zgjidhen këshillat e fshatrave dhe se si zgjidhet Kryetari i këshillit të fshatit. Në bazë të asaj që unë jam qe 20 vjet në Asamble, këshillat e fshatrave janë zgjedhur duke participu partitë politike me përqindjen e tyre që e kanë në atë fshat. Sipas meje partitë i delegojnë përfaqësuesit e vet në këshill dhe ky këshill mbledhet dhe normal Kryetari i atij fshati duhet të jetë partia që i ka fitu votat. Mirëpo në momentin që nuk mirren vesh, ata hyn në zgjedhje dhe cili ti merr votat bëhet Kryetar i fshatit. Kjo praktikë ka funksionu deri tash dhe nëse është diçka ndryshe, zyrtari ligjor le ta lexon ose komisioni i formuar për këshilla të fshatit të na sqaroj procedurën.

Dardan Berisha - në çdo takim e kam prezantuar rregulloren dhe ne jemi tu punu në bazë të rregullore me udhëzim administrative. Ju e keni edhe anëtarin tuaj në komision. Rregullorja nuk e thotë që Kryetari duhet me qenë patjetër i subjektit politik. Udhëzimi administrativ i 2019-tës nuk ka rregullore dhe nëse je për me ndryshu, edhe unë jam për me ndryshu sepse ka të meta por ne jemi tu shku me rregullore të 2012-tës.

Shefket Kolgeci - 3 anëtar janë të LDK-së, 2 janë të AAK-së, 1 i PDK-së dhe 1 të VV-së. I dërgum ne në këshill, kush i voton ata?

Liridon Fandaj - ftesa ka qenë publike.

Driton Maliqaj - në bazë të udhëzimit administrativ të viti 2019, është kuvendi i cili e zgjedh Kryetarin dhe nuk e njih forcën politike dhe asnjë subjekt politik me pjesëmarrës të numrave në bazë të zgjedhjeve të fundit lokale. Pra mentaliteti që secili subjekt politik duhet mi dërgu 2 anëtar apo 4 anëtar në bazë të peshës politike, ky udhëzim nuk e njih. Për mendimin tim as unë nuk jam pajtu me atë rregullore mirëpo është e vetmja rregullore.

Shefket Kolgeci - unë kërkoj ta lexoni rregulloren.

Dardan Berisha - përsëri jep sqarime rreth rregullore për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe thotë se janë konsultu dhe me zyrtarin ligjor. Poashtu thotë se deri më tani nuk kemi pas asnjë problem gjatë zgjedhjes, përveç në Vraniq.

Aziz Bytyqi - mendoj që kjo situatë duhet me u tejkalu me mirëkuptim, dhe më duket se këtu paska zbrazëti juridike për këtë çështje. Për hir të vërtetës në votim marrin pjesë ata që janë prezentë për derisa ftesa është publike.

Urim Suka - nëse jemi duke e zbatu udhëzimin e 2019-tës, është në rregull. Në qoftëse komisioni është duke zbatu rregulloren, rregullorja thotë: Ftesa i bëhet subjekteve politike dhe jo qytetarëve. D.m.th. keni gabu në thirrje.

Avni Bytyqi - para tre muajve e kemi themelua një komision për ti udhëhequr procedurat, jo për ti zgjedhur këshillat e fshatrave. Këshillat e fshatrave i zgjedhin vet banorët e fshatit dhe askush tjetër. Zyrtari ligjor tutje jep sqarim rreth rregullore dhe udhëzimit administrativ rreth zgjedhjes së këshillave të fshatrave. Zyrtari ligjor thotë që pas përfundimit të punës, komisioni e ka për obligim që ti raporton Kuvendit për udhëheqjen e procedurave për zgjedhjen e këshillave të fshatrave.

Shefket Kolgeci - a ka kontradita në mes udhëzimit administrativ dhe rregullore?

Avni Bytyqi - jo. Ministria e Pushtetit Lokal e ka nxjerr udhëzimin administrativ në bazë të rregullore sonë. Rregullorja jonë ta jep mundësinë që nëse një fshat pajtohet me përfaqësu një fshat tjetër dhe me i fuzionu, mundet me bo këtë. Ne poashtu e kemi parapa që komisioni ti ketë 5 anëtarë. Kjo është bartë në udhëzim administrativ dhe asgjë tjetër udhëzimi administrativ nuk flet për çështjen e procedurave të zgjedhjeve të këshillave të fshatrave.

Shefket Kolgeci - sa i përket praktiva,ne i kemi zgjedh deri sot dhe nuk kemi pas problem.Tash ndodhi sepse mënyra e zgjedhjes prej komisionit ishte jo e qartë,dhe subjekti juaj nuk kishte harmoni mes vete.

Reshat Selimaj - ne si Greikoc,prej mbas lufte kemi funksionu në bazë të përqindjes që kemi fitu.Ne kemi pas mundësi me i pas 100 vet,por anëtarët e partive politike që kanë fitu me përqindje kanë zgjedh.

Tash me rregulloren e re është një problem tjetër.

Driton Maliqaj - jep sqarime rreth praktikave për vitet '99 - 2009 për zgjedhje të këshillave të fshatrave dhe thotë që udhëzimi administrative 2019 dhe rregullorja 2012 i jep forcë Kuvendit,demokracisë.

Elmaze Bytyqi - pyetje për Drejtorinë e Financave: Si është e mundur që një biznesi ngarkohet me taksa komunale për disa parcela në Zonën Industriale në Shirokë,ku në ato parcela figurojnë biznese tjera dhe aq më keq që biznesit "Albiton"sh.p.k. për disa vite radhazi i merret pagesa.

Labinot Halitjaha - çdo biznesi në fillim të vitit në bazë të kodit primar i caktohen taksat në aktivitet.Nuk jam në dijeni për cilin biznes dhe përgjigjen mund ta jap me email.

Elmaze Bytyqi - sa leje ndërtimi janë lëshuar nga marrja e detyrës tënde si drejtor?Poashtu kam një shqetësim nga qytetarët se Drejtoria e Urbanizmit nuk po i lëshon pëlqimet për vendosjen e panelave solare,gjë që në Komuna tjera po ndodh.

Urim Suka - Pyetje për Dtejtorinë e Arsimit: 1.Kam tri kontrata që Komuna ka lidh me operatorët ekonomikë për transportin e nxënësve për vitin shkollor 2022-2023.Kontratat janë për fshatin Nishor dhe Greikoc.Për transportin e nxënësve janë lidh dy kontrata.Në kontratën e parë ju i paguani operatorit ekonomikë 108 euro në ditë,ndërsa në kontratën e dytë ju paguani operatorit ekonomikë 100 euro në ditë.Në total për transportin e nxënësve në fshatin Nishor ju paguani 208 euro në ditë ose 38.272 euro për një vit.Ndërsa për fshatin Greikoc keni lidh një kontratë për transportin e nxënësve për të cilën ju paguani 49 euro në ditë,në total 6.380 euro.Si ka mundësi që komuna për të njejtin shërbim të paguaj 208 euro në ditë për fshatin Nishor dhe vetëm 49 euro në ditë për fshatin Greikoc?

D.Shërbimeve Publike 2.Kontrata që keni lidh parasheh ndërtimin e rrugëve:Jetish Kabashi -seg.,Durmish Kabashi,Mehmet Gashi,Zeqir Kabashi,Sokol Kabashi,Riza Gashi,Azem Kabashi,Fazli Kabashi-seg.Por e vërteta është që 6 nga këto rrugë janë të shtrune në vitin e kaluar. 3.D. Arsimit dhe Kryetarit:Unë këto ditë kam pa një kontratë për meremetimin e shkollës në Samadraxhë,është bashkëfinancim.ndërsa siq na ke thënë Kryetar dhe siq dihet tashmë,Ministria e Arsimit ka vendos për ndërtimin e objektit të ri shkollor në Samadraxhë.Kërkoj sqarime.Gjithëashtu dua të di se si është përzgjedh lokacioni për ndërtimin e shkollës së re në Samadraxhë.Sipas disa informatave që ka shpalos Kryetari është vendos një parcelë shumë larg qytetarëve ku jetojnë?Për mua ka me qenë problem i madh për banorët dhe është mire me marrë një mendim të banorëve atje,dhe jo veq të dikujt.

Kryetari - 1.te bartja e nxënësve është dallimi shumë i madh për arsye se Nishori është me një hapsirë shumë të madhe dhe barten të gjithë nxënësat e Nishorit për arsye se shkolla është e ndërtuar gati në Kastërrc.2.Te Greikoci bëhet bartja e nxënësve vetëm nga lagjja e Kic-ve. Te Mohlani,procedurat e prokurimit shkojnë me meter katror dhe nuk bohen me rrugë,dhe ato mjete sipas planifikimit caktohen.Është kryesia e fshatit që merret me udhëheqjen e punimeve dhe ata i përcaktojnë ku të dojnë lokacionet. 3.Është një donacion që ka ardhë para një muaji,që është duke u meremetu 4.Lokacionin e ka zgjedh kryesia e fshatit Samadraxhë.

Urim Suka - nuk pajtohet me përgjigjet e Kryetarit dhe lexon kontratat.

Kryetari - ti mundesh mi marrë këto dosje dhe dërgoi në prokurori.

Laureta Tafaj - pyetje për derjtorin e Financave: Keni dal me një kerkësë që gjithë shfrytëzuesit e pronës publike të cilët kanë borgje mbi 300 euro të dërgohen te përmbaruesi.Çfarë masa ke marrë për këtë që e kërku vet?

Labinot Halitjaha - me ligjin e ri përcaktohet vlera mbi 300 euro për ata që kanë borgje ndaj Komunës me i dërgu në përmbarim.Unë e kam bë një shkrim në pranverë por shkaku i pandemisë dhe shkaku i inflacionit,gjendjes ekonomike të qytetarëve,ne jemi tërhek këtë vit me dërgu pjesën më të madhe në përmbarim,ndërsa pjesa që kanë borgje më të mëdha,ne vetëm kemi fillu me vërejtjet e para dhe tash pasojnë vërejtjet e dyta.

Laureta Tafaj - me një komision në mandatin e kaluar ne kemi has në borgje shumë të mëdhaja,sidomos shfrytëzuesi i tregut.Sot po thu që keni bo vërejtje.Vërejtje i kemi bo zotëriut moti.

Labinot Halitjaha - unë u përgjegjia për shumicën e qytetarëve,ndërsa për pjesën e bizneseve kemi fillu me bo vërejtje.Ne kemi dhe një problem që na është shfaq me programin financiar që jemi duke e përpunu dhe kemi me fillu me bizneset.

Laureta Tafaj - më njofto kur të fillon.

Liridon Fandaj - Pyetje Drejtorit të Pronës: Sa biznese operojnë me kontrata në Zonën Industriale,cilat janë veprimtaritë e tyre,a janë të vendosura në bazë të planit të Z.Industriale? Kam vërejtje që ka shumë kontrata që bizneset nuk janë aty,por nëse shkojmë në teren ne shohim biznese që nuk kanë lidhje me kontratat që mi ke ofru ti.Kërkoj nga ju,të dalësh në teren dhe të shohësh që në Z.I. ke biznese duke operu ilegalisht dhe nuk kanë kontrata me Komuna ose kanë lidh kontrata që nuk kanë ardh në Asamble.Pyetje për Drejtoreshën e Kulturës: në bazë të thirrjes publike e di që kanë apliku shumë OJQ për subvencionim.A e keni marrë parasysh vërejtjen e auditoritit të vitit të kaluar dhe a i keni verifiku vërtetimet tatimore?Pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë: Pse nuk po furnizohen me barna AMF-të në Sallagrazhdë dh Bukosh dhe në disa AMF tjera, kur kërkesat janë me javë të tëra?

Kryetari - pyet asambleistët se a kanë pyetje për të,sepse ka njaë takim me USAID.

Dorentina Zenelaj - në fshatin Savrovë në buxhetin që është votu,ka qenë rruga Livadhet e Buta.A do të shtrohet rruga për banorët apo rruga fushore?

Kryetari - te rrugët fushore është fondi i bujqësisë dhe te infrastruktura janë rrugët që janë të parapara dhe që kanë kalu në buxhet.

Liridon Fandaj - pasi nuk është Drejtoresh e Inspeksionit,Kryetar a po del në teren me pa se sa ndërtimi pa leje është duke u rregullu në Komunën tone?

Kryetari - në prona Komunale nuk kam vërejtje askund që është duke u ndërtu.Në qoftëse ndërtohen pa leje, kemi me rrënu.

Liridon Fanda - jo komunale,por private.

Kryetari - interesi i Kryetarit të Komunës është me i mbrojtë një herë pronat publike dhe komunale.Por në qoftëse është ndërtu dikun në prona komunale,po ta jap fajlën që kemi me i rrënu.Por nëse është fajal për prona private është mire me na tregu.

Liridon Fandaj - prona është përballë biznesit tend,kur ti në një kohë e ke rrënu një biznes tjetër për interesa tua.Është duke u ndërtu një fabrikë poshtë që nuk ka leje ndërtimi.

Kryetari - do ta sqarojmë atë kërkesë,por unë asnjëherë s'kam rrënu atje sepse nuk kam qenë Kryetar në atë kohë.

Armend Krasniqi - në Zonën Industriale aktualisht ekzistojnë 53 kontrata.Sa i përket se si operojnë këto kompani,është një komision i përbërë nga Kryetari,i cili komision në të kaluarën i ka shkëput 10 kontrata në Agro Zonë dhe një në Zonë Industriale.Sa i përket se a shkoj me vizitu,shkoj shumë dhe njoh shumë mire nga afër çdo biznes se si operon dhe çfarë operon.Faktikisht komisioni është përgjegjës për ato kompani që nuk i respektojnë apo nuk i përmbahen rregullores se çka është e paraparë me u punu në atë zone.

Liridon Fandaj - unë ju pyta,a operojnë biznese që nuk kanë kontratë.Dhe përgjegjësia është mbi drejtorinë tuaj.

Armend Krasniqi - drejtoria jonë nuk është përgjegjëse për veprimet se çfarë i bon zona.Përgjegjëse është zyra e Kryetarit e cila ka të formuar një komision.Komisioni është akoma funksional dhe me rekomandimet që i bën në fundvit,besoj ka me pas edhe shkëputje tjera të kontratave nëse nuk janë duke iu përmbajtur rregullores në kontratë.

Driton Maliqaj - jep sqarime sa i përket pyetjes.

Liridon Fandaj - unë e kam shqetësimin në atë zonë që operojnë biznese që nuk kanë kontratë të lidhur me Komunë.

Driton Maliqaj - ajo është nën kontratë e që nuk është e lejuar.

Lorika Gashi - e kemi marrë parasysh dhe i kemi marrë vërtetimet e ATK-së.E kemi marrë një këshill nga auditorët e jashtëm,dhe kemi shku në bazë të atyre rekomandimeve.Është komisioni i cili i ka hap zarfat e aplikuesve dhe me vlerësimin e komisionit të gjithë janë të paisur me vërtetimet e ATK-së.

Besa Kuçi - është mire që po interesoheni për këto qështje,dhe në të njejtën kohë ju ftoj të na ndihmoni në secilën pjesë ku ju mundeni me dhënë kontributin tuaj.Sa i përket furnizimeve me barna te AMF

Sallagrazhdha dhe QMF Bukoshi,jo vetëm këto dy AMF dhe QMF por të gjitha rrjetet e AMF-ve dhe QMF-ve furnizohen në baza mujore në bazë të kërkesave.Është shumë më mire nëse ju e keni datën e kërkesës kur është bo nga stafi përgjegjës,sepse është më e lehtë dhe do ti drejtohem depos se pse nuk është plotësuar kjo kërkesë.Gjithësesi do të interesohem për këtë çështje.

Liridon Fandaj - unë e ngrita vetëm si shqetësim të qytetarëve ,por nuk kam naj fakt që është bo kërkesa dhe nuk është furnizu.

Selman Kolgeci - pyetje për Drejtorin e SH.Publike në lidhje me rrugën Mushtisht-Sallagrazhdë-Greikoc-Korishë.Kam marrë shqetësim prej banorëve që ia keni marrë pronën,që as nuk ia keni shpronësu, as nuk e keni pyet e as nuk e keni njoftu.Bëhet fjalë për Sallagrazhdë.A ka projekt ajo rrugë dhe nëse ka a është duke u zbatu ?Nëse është duke u zbatu,e di që shpronësim nuk ka .A keni ndërmarrë diçka për me shpronësu pronën private në të cilën po kalon kjo rrugë?

Enver Shabani - është e vërtetë kjo ,projekti ka fillu për ndërtimin e rrugës Mushtisht-Baqevc-Sallagrazhdë-Greikoc.Unë ju garantoj që secilit pronar toka private ka me iu kompenzu.Deri më tani nuk kemi fillu me ndonjë procedurë të shpronësimit.Drejtori tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - ajo që po kërkoj është që nëse nuk ka shpronësim,të bëhet evidentitmi i secilës hapësirë,secilit dam e secilës hapësirë që po i merret qytetarëve,në mënyrë që kur të fillon vlerësimi për shpronësim ti kemi të dhënat e sakta,por jo vetëm në këtë rrugë,por në secilën rrugë që ndodh kjo.

Enver Shabani - e kanë pas një takim trepalësh,operatori ekonomikë,të dëmtuarit ,menaxheri i kontratës dhe mbikqyrësi nga USAID, dhe kanë bërë një raport në detale se çka do me u bë, se se sa metra do ti merren x pronarit të tokave.Dhe e theksoj prap që ne nuk jemi të interesum me i bo dëm asnjë qytetari,por jemi të interesuar për investime,ndërtime në shfrytëzimin e shumicës por jo duke dëmtuar të tjerët.

Takimi përfundoi: 13:10

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj